

I. Kriteret dhe specifikimet e ambientit:

- (a) Ambiente për zyra me sipërfaqe totale 1100 – 1200 m², **të mobiluara dhe të përshtatshme për akomodimin e rreth 100 punonjësve**; përfshirë minimumi 4 tualete (të kompletuar me pajisjet hidrosanitare dhe pajisjet për ujë të ngrrohtë).
- (b) Ambienti duhet të sigurojë përmbushjen e kërkesave minimale sipas kuadrit ligjor për hapësirat në vendin e punës.
- (c) Ambientet ku do të akomodohet stafi i SASPAC të jenë në Tiranë dhe lehtësisht të aksesueshme nga institucionet e tjera shtetërore apo dhe me zyrat e përfaqësive diplomatike, donatorëve dhe partnerëve të tjerë zhvillimorë me të cilat SASPAC ka bashkëpunim të vazhdueshëm.
- (d) Preferohet që ambientet për qiradhënie të pozicionohen në katet e ulëta, jo më lartë se në katin e katërt të godinës. Në rast se ambientet janë më lart se në katin e katërt të godinës, të sigurohet ashensor i veçantë për zyrat i ndarë nga pjesa rezidenciale e godinës.
- (e) Ambientet në të cilën do transferohet SASPAC të plotësojë kushtet për zhvillim normal të punës sipas mandatit që ky institucion ka, **pa pasur nevojë për kryerjen e investimeve shtesë**.
- (f) Ambientet të kenë minimumi 2 (dy) vende parkimi për automjetet.
- (g) Instalimet elektrike të jenë të përshtatshme dhe të mjaftueshme për postet e punës.
- (h) Ambientet duhet të kenë furnizim me ujë dhe energji elektrike 24/7.
- (i) Ambientet duhet të kenë sistem kondicionimi dhe në rastet kur nuk ka aspirim natyral edhe sistem aspirimi, të instaluar dhe plotësisht funksional.
- (j) Ambientet duhet të kenë rrjet intraneti të instaluar.
- (k) Ambientet duhet të jenë të lira, dorëzimi i objektit do të bëhet brenda 5 (pesë) ditëve pune nga njoftimi për lidhje kontrate.
- (l) Detyrimet që lindin nga përdorimi i energjisë elektrike dhe ujit gjatë periudhës së vlefshmërisë së Kontratës së qirasë do të përmbushen nga SASPAC.
- (m) Ndriçim artificial ose natyral të nevojshëm;
- (n) Të sigurohet vend në hyrjen kryesore për vendosjen e tabelës identifikuese të Institucionit shtetëror.
- (o) Tryeza ose syprina e punës kanë sipërfaqe të mjaftueshme me gjatësi të paktën 1200 mm dhe me gjerësi të paktën 750 mm.
- (p) Karrigia e punës duhet të jetë e qëndrueshme dhe i lejon punonjësit lirshmëri lëvizje dhe pozicion të rehatshëm. Ndenjësja ka lartësi të ndryshueshme prej 400 – 520 mm, thellësi prej 350 – 500 mm dhe gjerësi rreth 480 mm. Mbështesja e ndenjësës është e ndryshueshme në lartësi dhe pjerrësi.

II. Dokumentacioni kualifikues do të jetë:

Ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentacionin **original ose fotokopje të noterizuar, i lëshuar brenda tre muajve nga data e zhvillimit të procedurës, si në vijim:**

- a) Vërtetim si titullar i ligjshëm i pronës të vërtetuar me certifikate pronësie, lëshuar nga ASHK-ja, shoqëruar me kartelën e pasurisë, hartën treguese të pronës dhe Gent-planin.
- b) Vërtetim hipotekor që prona nuk është në sekuestro dhe është e lirë nga çdo barrë hipotekor apo detyrim tjetër ligjor, lëshuar nga ASHK-ja.
- c) Vërtetim që nuk ka detyrime të pashlyera dhe kopje të kontratës së furnizimit të energjisë elektrike.
- d) Vërtetim që nuk ka detyrime të pashlyera dhe kopje të kontratës së furnizimit nga ujësjellës-kanalizimet.
- e) Vërtetim që ofertuesi nuk është në ndjekje penale apo proces gjyqësor.
- f) Deklaratë që nuk ka konflikt interesi me SASPAC;
- g) Vetë-deklarim mbi përmbushjen e specifikimeve teknike.
- h) Nëse është tregtar/shoqëri tregtare duhet të paraqesë edhe:
 - (i) NIPT/NUIS, certifikata e regjistrimit dhe Ekstrat Historik i regjistrimit të subjektit që vërteton se ka status aktiv.
 - (ii) Vërtetim nga tatim-taksat që nuk ka detyrime të pashlyera.
 - (iii) vërtetim që nuk ka sigurime shoqërore të pashlyera nga e-Sigurime.

SASPAC do të pranojë oferta si nga persona fizik dhe juridik të cilët plotësojnë kriteret dhe dorëzojnë dokumentacionin kualifikues

III. Paraqitja e dokumenteve dhe ofertës së qirasë së ambienteve:

- (a) Dokumentacioni i kërkuar më sipër duhet të jetë i futur në një zarf jo transparent, të mbyllur, të vulosur dhe të firmosur me emrin dhe adresën e ofertuesit. Mbi zarf duhet të jetë shënuar: ***“Ofertë në kuadër të marrjes me qira të ambiente të mobiluara zyresh për ushtrimin e veprimtarisë së Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC)”***.
- (a) Oferta e qiradhënësit që specifikon sipërfaqen dhe çmimin total mujor (**në LEK**) si më poshtë:

<i>Sipërfaqe totale e ambienteve</i>	<i>Çmimi për m²</i>	<i>Çmimi total (Lek në muaj)</i>

- (b) Dorëzimi i dokumenteve dhe ofertës ekonomike duhet të bëhet brenda **datës 24/02/2023, ora 14:00**, me postë ose dorazi pranë *Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës (SASPAC)*, me adresë: Bulevardi Dëshmorët e Kombit”, pranë Kryeministrisë, Tiranë. Nëse dorëzimi do të bëhet nëpërmjet shërbimit postar, zarfi duhet të ketë datën 24 Shkurt 2023 ose më herët nga kjo datë.
- (c) Ofertuesi duhet të pranojë që pagesa e qirasë të bëhet çdo muaj në lekë, bazuar në çmimin e ofruar dhe sanksionuar në kontratën e qirasë, kundrejt lëshimit të faturës tatimore.

IV. Kriteret Vlerësuese

Oferta fituese do të jetë oferta ekonomike më e favorshme, e cila plotëson të gjitha kriteret ligjore dhe kërkesat e përcaktuara në njoftimin për marrjen e ambienteve me qira për zyrë, për punonjësit e SASPAC.